



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të neneve 13.7, 14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe të neneve 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, të dt. 3.7.2003, të shpallur sipas Rregullores nr.2003/30, të dt.10.9.2003; të neni 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr.2000/45, të dt.11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika “b” dhe të nenit 40, par.3, pika II.të Statutit dhe rregulloreve të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2007, merr

## **V E N D I M**

### **PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES PËR LAGJEN “LAKËRISHTJA”**

#### **Neni 1**

Fillon hartimi i Planit rregullues për lagjen “Lakërishtja” në Prishtinë.

#### **Neni 2**

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është harmonizimi i planeve urbanistike ekzistuese të lagjes, nga neni 1 i këtij Vendimi, me dispozitat e Ligjit për planifikim hapësinor. Në bazë të Planit rregullues, do të bëhet caktimi i kushteve për rregullimin e hapësirës, si dhe caktimi i rregullave të lokacionit të objekteve , linjave rregulluese, linjave të ndërtimit, normave teknike urbanistike dhe kushteve të tjera lidhur me lokacionin e ndërtesave dhe ndërtimeve tjera në ngastrat brenda kufijve të përshkruar me nenin 3 të këtij Vendimi, konform destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr.01-031-1231/1, të dt.2.7.2004.

#### **Neni 3**

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës, e miratuar si lagjja “Lakërishtja”, e cila shtrihet nga ura në drejtim të Fushë-Kosovës, përkufizohet me rr. “Tirana”, gjegjësisht unazën e Qendrës, përbri lagjes “Arbëria 3”, pastaj me rr.”Garibaldi”, rr “Kosta Novakoviqi”, rr. “Robert Doli” dhe përmbillet me bulevardin “Bill Klintoni”.

Kjo hapësirë mbulon një sipërfaqe prej 52.35.00 ha dhe karakterizohet me pozitën e saj në strukturën e qytetit, si dhe me përmbajtjet e saja ekzistuese për banim, përmbajtje industriale dhe arsimore.

#### **Neni 4**

Bartësi i detyrave programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet më vonë.

#### **Neni 5**

Mjetet financiare plotësuese për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendim, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 6**

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës si projektplan, në mënyrë që ai të nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

#### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtoritë e Komunës së Prishtinës janë të obliguara që të sigurojnë dhe të ia dërgojnë shënimet për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendim, Drejtoratit të Planifikimit, Urbanizmit dhe të Ndërtimtarisë.

#### **Neni 8**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.Nr. 35-129, më 29.03.2007**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**